



Një perspektivë Islame mbi pandeminë

Description

Tim Winter (Abdyl Hakim Murad)

Shaban 1441 / Prill 2020

Bismilahi Rrahmani Rrahim

Bota është në agjërime – ky është *imsaku* i kapitalizmit, Gostia e Belshazarit (gosti me enët e grabitura pas shkatërrimit të Tempullit të Zotit sh.p.) u ndërpre krejt papritmas; një vizitor që vjen në një qendër qyteti sot sheh që shumëçka është e mbyllur; siç na tregon një hadith që flet për Ramazanin, djajtë janë të lidhur me zinxhirë, *sufidet el-shejatin*. Blerësit që i kanë sytë katër janë të intresuar jo për sende të këndshme por për mbijetesën; zakoni e vjetër i këqyrjes me nge të mallrave duket absurd. Kryeministri ynë [britanik, sh.p.], duke shpалosur sheshazi shpirtin e tij hedonist, i ka mbyllur libraritë por ka lënë hapur dyqanet e pijeve alkoolike; por ama edhe këto nuk duket se kanë punë. Shumë njerëz janë të sjellshëm dhe të kujdesshëm, por të gjithë janë të nënshtruar, të esëllt, të kujdesshëm, e si të zdruguar.

Sigurisht, ky rrënim i papritur po bie në mënyra të ndryshme mbi krye të ndryshme. Për të moshuarit, e tështitura ime e pakujdeshme mund të sjellë një vdekje të tmerrshme; për të rinjtë që rrinë bashkë e që qeshin, në pritje të autobuzit, rreziku duket fare i papërfillshëm – kjo Ruletë Ruse që ata luajnë çdo ditë është e re dhe shkakton emocion, dhe ata ndihen të pavdekshëm, me besimin në vete se ata do të jenë duke pritur të njëjtin autobus të paktën edhe vitin tjetër.

Kështu që ka qenë e shkruajtur që ne të rrojmë në kohëra interesante; po hyjmë në krizën më të rëndë globale që prej dekadash; dhe për myslimanët është koha që të reflektojnë, duke përfituar nga këto ditë rishtazi të gjata e të qeta. Por përpara se ta bëjmë këtë, le të vetë-karantinohemi nga media sensacionale dhe plot panik, le të mos klikojmë dhe të mbyllim veshët përpara politikanëve të hutuar e të dorës së dytë; le të vështrojmë nga dritaret tona mbi zbrazëtinë e mbinatyrshme të rrugëve, dhe të shqyrtojmë se çfarë mund të ketë dashur të thotë Zoti me gjithë këtë.

Edhe truri ateist e njeh kohën tonë si një epokë të rrënojave: ne e plaçkisim dhe e dhunojmë çmendurisht natyrën dhe vëmë këmbën në hënë; çdo specie tjetër na përulet teksa ekosistemet vdesin; sistemi ynë financiar bën përherë e më tepër një gjueti prej paraziti mbi skamnorët. Nga perspektiva jonë njerëzore Covid-19 është një infeksion që çrregullon botën tonë; por e parë nga perspektiva e botës, vetë njerëzimi, gjatë epokës së fundit, është bërë një sëmundje edhe më vdekjeprurëse: si kërpudha apo krimba parazitë, ne thithim gjakun e bujtësit, duke u shumëfishuar në mënyrë të çmendur derisa vetë ekosistemi, planeti që ne vampirizojmë, fillon të sëmundet e të vdesë. Beni Ademi, i biri i Ademit, i çliruar nga kufizimet natyrore që feja nxit, është bërë një sëmundje, me një inteligjencë jo më të madhe se një mikrob në planifikimin dhe urtësinë e tij. Ne jemi bërë një Karun-virus (Karuni përshkruhet si një pasunar i madh që e përdorte pasurinë për të persekutuar popullin e Musait sh.p.).

Dhe tani bota e Zotit po na shpague me këtë duhmë të helmët të padukshme e cila na bën që të kemi tmerr në çdo frymëmarrje. Putini dhe Trumpi, padronë të arsenaleve bërthamore, janë zbythtur se mos ajo i zë, duke zbuluar, ndoshta, rregullin nakshibendi të *khush dar dam*, “ki mendjen në çdo frymë”. Një armik kaq i vogël ka përmbysur botën tonë: tejet e vogël për t’u parë, korona do të thotë fjalë për fjalë kurorë: kjo proteinë e papërfillshme mikroskopike, kjo gati-gati një hiç, është bërë tani mbreti i botës.

Në këtë ironi hyjnore ne sjellim ndërmend fabulat e vjetra të zhanrit “miu dhe elefanti”. Pejgamberi Muhamed, kumti i të cilit është i gjithi një sfidë ndaj dashurisë për dynjanë dhe frikës nga vdekja, lindi në Vitin e Elefantit; sa e sa herë e përsërisim atë sure kuranore, a thua se është një vjershë kopshti: por Abrahaja, tirani, mbetet një simbol i përjetshëm i arrogancës që kërkon të zhvendosë punët e Zotit; autorët e Siras, biografisë së Pejgamberit, na tregojnë se zogjtë që lëshuan toptha balte mbi të dhe ushtrinë e tij sollën edhe një sëmundje tek ta, aq sa mishi filloi t’u kalbëzohej në kockat e tyre ndërkohë që ata ishin ende gjallë. Ishte një lloj i tmerrshëm Ebole, që i hante ata për së gjalli. *Fe xhe’alehum ke-asfin me’kul*.

Pra, mikrobet, që janë pjesë e simfonisë së ekosistemit të balancuar të botës, i përkasin edhe ata gjithashtu ushtrisë së Zotit. Ka raste që ata na shërbejnë nëpërmjet emrave hyjnorë *Rezzak*, *Latif* (Furnizuesi, i Miri sh.p.): stomakët dhe zorrët tona gëlojnë sosh, dhe pa to ne nuk mund të tresim vaktet që hamë; mbi tokë ato shpërbëjnë lëndën e vdekur dhe ia kthejnë dheut; ato kufizojnë popullatat në mënyrë të natyrshme, duke ruajtur ekuilibrin, *mizan*, e krijimit, në të cilin çdo specie ka të drejtën që të ketë hapësirën e saj. Por herë të tjera, jo më pak të nevojshëm për ekuilibrin, ata u shërbejnë emrave hyjnorë si *Kahhar* dhe *Muntakim*, Shtërnguesi dhe Hakmarrësi, dhe kështu Allahu i përdori ata për të goditur oligarkun Abraha dhe elefantin e tij, komandot e tij dhe flotën e tij.

Allahu thotë se Ai është me të varfërit dhe zemëthyerit: *ene ‘inde’l-munkesirati kulubuhum*. Kurani na trazon me argumentet e tij pejgamberike të pakompromisa kundër pozitës, krenarisë, dhe grumbullimit të pasurisë. Sheriati, me Zekatin e tij dhe ligjet e trashëgimisë, synon që të shpërbëjë pasuritë, duke i shkërmoqur ato me çekiçin e drejtësisë së Zotit; në kundërdallim, skemat moderne parazite të *homo economicus* kanë cuar drejt një grumbullimi historikisht të pabarabartë të pasurisë nga vetëm një përqind i popullatës së globit.

Dhe kështu historitë e mëdha kuranore që rrëfejnë se si e vërteta ballafaqohet me pushtetin na kallëzojnë pa reshtur se Faraoni përmbysset, jo nga një superfuqi tjetër, por nga një profet i thjeshtë i veshur me zhele, një pjesëtar i një race të përbuzur e të nënshtruar që përbëhej nga punëtorë e

imigrantë të importuar, një njeri që ka vënë në dyshim madje edhe aftësinë e vet për të folur siç duhet. Këmbëzbathur, ai qëndron përpara frontit të Memfisit, duke sfiduar haptazi magjistarët e shtetit autokratik, pasuria e të cilit është e orientuar në mënyrë të marrëzishme drejt krijimit të mauzoleumeve prej mermeri për të vdekurit të cilët, nga ana tjetër, i ha dhe; autokrati kthen shpinën me neveri ndaj kumtit të profetit, dhe fatkeqësitë bien mbi tokën e tij, Egjiptin. Çfarë fuqie mund të ketë ministri i tij i mbrojtjes kundër bretkosave, gjakut, dhe infeksionit që mbulon atë dhe popullin e tij me çibanë të qelbëzuar? Sërish, pjesëtarët më të vegjël të mbretërisë së natyrës përdoren nga providenca hyjnore për të goditur një megastrukturë shkatërrimtare e të padrejtë të represionit dhe krenarisë.

Dhe sërish, le të sjellim në kujtesë qëndrimin heroik të Ibrahimit/Abrahamit në oborrin e Nimrodit. Këtë e gjejmë në suren Bekare:

“A nuk e ke parë atë që debatoi me Ibrahimin në lidhje me Zotin e tij; dhe Allahu ia kishte dhënë atij mbretërinë. Dhe Ibrahimu tha: Zoti im është Ai që jep jetë e vdekje; dhe ai iu përgjigj: [edhe] unë jap jetë e vdekje.”

Komentatorët kanë shënuar se Nimrodi e shpërfaqti pushtetin e tij plot krenari e zemërngurtësi duke i dhënë faljen një të burgosuri dhe duke ekzekutuar një tjetër: pushteti gati hyjnor i aministisë që një sundimtar ka.

“Dhe Ibrahimu tha: Allahu e sjell diellin nga lindja; sille ti nga perëndimi”; dhe kështu ai që mohoi u refuzua, dhe Zoti nuk e udhëzon popullin e padrejtë.”

Autorët e tefsirit, ekzegjzës kuranore, përmendin se njerëzit vinin te Nimrodi, dhe e pohonin atë si zotin e tyre, *rabb*; ai më pas u jepte atyre ushqime.

Dhe në këtë kontekst vjen Ibrahimu, dhe kur atij i bëjnë po të njëjtën pyetje, ai thotë: *“Rabbij el-ledhi juhji ue-jumi’*”, Zoti im është Ai që jep jetë dhe vdekje.

I përzënë nga prania e tiranit dhe teksa po kthehej për tek familja e tij, Ibrahimu i mbush trastat e tij me rërë, kështu që të paktën për një copë herë familja e tij do të mendojnë se ka çuar diçka në shtëpi, dhe kësodore do të gjejnë ca ngushëllim. Ai bie të flerë; dhe kur Sara, gruaja e tij, hap trastat, ajo sheh se ato, për mrekulli, ishin të mbushura me grurin më të shkëlqyer.

Sa për Nimrodin, kronikat përmendin se ndërkohë që ai po administronte formën e tij të drejtësisë, një mushkonjë apo një mizë i hyri në flegrenë e hundës: *febe’athe’Llahu ‘alejhi ba’ude, fedekhalet fi menkharahi*. Insekti e pickonte, dhe kjo i shkaktonte atij një vuajtje kaq torturose sa që ai zuri të guante me kokë muret e pallatit të tij, derisa, mbas disa vitesh dhimbjeje, ai vdiq.

Sigurisht, argumenti këtu është se krijesat më të vogla mund të rrëzojnë arrogancën më kryeneçe njerëzore. Dhe në kohën tonë, është virusi ai që e mban kurorën, dhe të fuqishmit janë ata të cilët janë të pashpresë dhe të përulur. Shikoni politikanët në mbarë Europën të cilët kanë persekutuar traditat e nderuara të Islamit: janë pikërisht ata, tani, të cilët janë të shtrënguar të mbajnë veshur ferexhenë, apo nikabin.

Murtaja dhe kolera nuk janë aspak diçka e re apo befasuese në Islam. Po të hedhim vështrimin në

tekstet tona, ne do të gjejmë se *ueba'* përkuzohet si epidemi, dhe *i'da'* si sëmundje ngjitëse, dhe Islami mesjetar e di si mos më mirë se rezultati mund të jetë një masakër. Ibn Batuta, kur përshkruan Vdekjen e Zezë në Kajro, shënon se në atë kohë po vdisnin njëzet mijë njerëz në ditë; dhe imamët thërrisnin me zë të lartë: “Shehadeh, shehadeh!” S’ka dyshim se referenca këtu ishte ndaj hadithit të transmetuar nga Buhariu ku thuhet se ata të cilët qëndrojnë në një vend ku ka rënë murtaja, duke llogaritur që asgjë nuk mund të bjerë mbi ata me përjashtim të caktimit të Allahut, do të marrin shpërblim të ngjashëm me atë të dëshmorëve.

Por për shkak se myslimanët e çmojnë mjekësinë, dhe se edhe vetë Profeti ka këshilluar që të përdoren barnat, në historinë e Islamit ka patur shërbim shëndetësor të ofruar me bujari nga vakëfet. E kam fort për zemër këtë përshkrim të një spitali mesjetar egjiptian, të shkruar nga historiani Lane-Poole:

“Dhomëzat për pacientët ishin të radhitura përreth dy oborrëve, dhe në anët e një katërkëndshi tjetër kishte pavijone, oda leksionesh/dersesh, bibliotekë, banjo, punishte barnash, dhe madje edhe mjetet e domosdoshme të aso epoke për shkencën kirurgjikale. Kishte madje edhe muzikë për të përtërirë ata që vuanin; ndërkohë, kënduesit e Kuranit përhapnin ngushëllimet e fesë. Pasunarë e skamnorë trajtoheshin njëllor, pa pagesë, dhe gjashtëdhjetë jetimë mbaheshin dhe edukoheshin në medresenë ngjitur [me spitalin].”

Historianët pajtohen se spitali i epokës moderne, ç’është e vërteta, ka zënë fill në botën islame: ka një shpjegim të mirë të kësaj në një shkrim të *Aramco World Magazine*, të titulluar “Rrënjët islame të spitalit modern” (*The Islamic Roots of the Modern Hospital*), që mund të gjendet lehtësisht *online*, dhe që, në gjykimin tim, të gjithë profesionistët mjekësorë duhet ta lexojnë me patjetër. Artikulli në fjalë fillon me një citim nga *vakfija* e spitalit të Sulltan Kalaunit:

“Spitali i mban të gjithë pacientët, burra e gra, derisa ata të shërohen plotësisht. Të gjitha shpenzimet i merr përsipër spitali pavarësisht nëse njerëzit vijnë nga larg apo nga afër, pavarësisht nëse janë banorë të zonës apo të huaj, të fortë a të dobët, shtresës e ulët apo e sërës, pasunarë a skamnorë, me punë a pa punë, të verbër a me shenja, fizikisht a mendërisht të sëmurë, të lëçitur apo pa shkrim e këndim. Në asnjë rrethanë nuk ka pagesë apo shpërblim; askush nuk i nënshtrohet asnjë forme pagese, qoftë kjo edhe e aluduar në mënyrë të tërthortë. I gjithë shërbimi është falë madhësisë së Zotit Bujar.”

Spitali, pra, *Dar el-Shifa*; apo *bimaristan*, është njëra nga dhuratat e Islamit për Perëndimin, dhe ka dalë nga një kulturë në të cilën dhembshuria por edhe profesionalizmi mjekësor kanë qenë çmuar tej mase. Sa shumë të përbashkëta gjejmë midis asaj kulture që ka patur ndikim dhe kësaj kulture që është ndikuar! Dhe megjithatë ajo kulturë ndryshonte nga kultura jonë në një aspekt kyç.

Mjekët myslimanë paramodernë, si dhe ulematë e asaj kohe të cilët kanë shqyrtuar gjerë e gjatë sëmundjet ngjitëse, kanë marrë si të mirëqenë një botë sociale në të cilën pritshmëritë njerëzore nga jeta dhe dynjaja ishin modeste. Tmerret në lidhje me vdekjen dhe një dashuri për bollëkun janë më tepër trashëgimi, apo sunet, i Nimrodit dhe i Faraonit; ato janë udha e Ebu Xhehlit, jo ajo e Vulës së Pejgamberëve; siç thonë poetët, ato pasqyrojnë materializmin e gomarit, jo të Isait/Jesusit që i ka hipur atij. Qëndrimet tona moderne ndaj vdekjes janë tejet jorealiste, bishtnuese dhe plot ankth: besimet ateiste, që janë përhapur si viruse falë lëndës së papastër që është akumuluar në zemrat tona, kanë bindur njerëz të shumtë të mendojnë se vdekja klinike është fundi ynë. Siç përshkruhen në Kuran

njerëz të tillë: “Ata thonë, ekziston vetëm jeta e kësaj bote, ne ishim të vdekur, dhe ne jetojmë, dhe vetëm Koha na vret.”

Njerëz të tillë janë tragjikisht të tmerruar nga vdekja; në fakt, kjo përbën terrorizmin kryesor që trazon njerëzimin në epokën tonë: kërcënimi i mbrapshtë se mbas vdekjes vjen një asgjë e pakuptimtë, e përjetshme. Në Arabinë e vjetër, arabët xhahilë nuk besonin aspak në jetën mbas vdekjes; por Njeriu të Lëvduar, në çastin e tij më të trishtuar kur u përballë me ata, atij Zoti i tha: “bota tjetër ka për të qenë më e mirë për ty se sa kjo”. Dhe në Suren el-‘Ala: “ti parapëlqen jetën e kësaj bote, por jeta tjetër është më e mirë dhe më e qëndrueshme.”

Vdekja është një pjesë normale dhe e natyrshme e realitetit tonë të brishtë njerëzor, dhe dekreti i saj vjen nga një emër i paepur hyjnor, *el-Mumit*, Ai që mundëson vdekjen. Njerëzimi paramodern e shihte atë në çdo kah, dhe dinte si të merrej me të; ritualet ndihmonin në një masë të madhe, por madje edhe më shëruese ishte vetëdija për urtësinë dhe rahmetin/mëshirën hyjnor/e. Kështu, Njeriu i Lëvduar (Muhamedi) ka thënë një fjalë që ka zënë vend: “*tuhfet el-mu’min el-meuf*”, vdekja është dhuratë e çmuar për besimtarin; kjo sepse ai apo ajo shpërngulet nga bota e zhgënjimit për në botën e mëshirës dhe të kuptimit të kulluar. Është e vërtetë se Pejgamberi i Nderuar na thotë që të mos e shpresojmë vdekjen, “asnjëri prej jush të mos e shpresojë vdekjen”, sepse fundi ynë është me dekretin Tij, jo sipas preferencës tonë. Ne thjesht e pranojmë atë me qetësi si një shprehje e plotë e urtësisë hyjnore.

Pa dyshim, kjo është njëra prej arsyeve përse besimtarët gëzojnë rezultate më të mira të shëndetit mendor se sa ateistët; një artikull i vitit 2013 i *Daily Telegraph*, pasi vë në dukje se besimi fetar është i qenësishëm për qeniet njerëzore, propozon që vetë ateizmi duhet të klasifikohet si një sëmundje mendore. Por ai është një infeksion i përhapur gjerësisht, me simptoma të shëmtuara psikologjike, dhe në Britaninë moderne kjo është mëse e dukshme. Mizoria monstruoze e besimeve ateiste shpaloset në mënyrën më të thukët nga vuajtja e familjarëve kur ata marrin lajmin se një njeri i dashur ka vdekur në terapi intensive. Një zbrazëti zëvendëson një shpirt; nuk bëhen rituale të pakoha; nuk ka asnjë dritëz shprese.

Ka një trashëgimi myslimane britanike mjaft frymëzuese në këtë pikë. Historia e saj fillon me bashkësinë e Abdullah Quilliam në Liverpulul e shekullit të nëntëmbëdhjetë; në një vend e në një kohë të ashpër ku armiqësia dhe kërcënimet ishin madje edhe më të përhapura nga ç’janë sot. Por Quilliam besonte në Islamin Tradicional, dhe fryma e asaj që ai e quante dorëzim islam është një lajtmotiv në të gjitha shkrimet e tij. Për shembull, ai ka poezinë e tij karakteristike “Shtegtimi i Fundit”:

Kur retë sterren e bjerren

Përfund udhës vdek'tare;

Kur hapat ngurrojnë e lodhen

Në shtëpi vete e gjej prehje –

Përhera aty kam ndeje.

Mendoj për të dashurit e zemrës

Kam kohë i ndarë prej tyre
Në zemër se ç'feks ciltërsia
Në shtëpi vete e gjej prehje –
Përhera aty kam ndeje
Malli e bën zemrën më të ngrohtë
Të paktën kështu thonë poetët;
Dhe atje nuk do ketë ndarje
Në shtëpi vete e gjej prehje –
Përhera aty kam ndeje
Ndonëse i vetëm eci në shteg
Ndonëse shteren fuqitë vdek'tare.
Këmbët shkelin në truall të sigurtë
Në shtëpi vete e gjej prehje –
Përhera aty kam ndeje
Herët a vonë vjen thirrja
së cilës duhet t'i bindem
Plot lumni do t'i përgjigjem,
Në shtëpi vete e gjej prehje –
Përhera aty kam ndeje

Një tjetër autor i asaj epoke të hershme të bashkësisë sonë britanike është edhe Amherst Tyssen. Më pëlqen poezia e tij mbi Pejgamberin dhe Hazretin Ebu Bekr, kur ata gjetën strehë në shpellë nga bandat e vrasësve kurejshë të cilët po përpiqeshin që të pengonin Hixhretin duke i vrarë ata. Poezia e tjerr pejzën e saj nga e dhëna kuranore: *thanije thnejni idh huma fi'l-ghari idh jekulu li-sahibi la tahzen inne'l-Llahu me'ana* – “i dyti prej të dyve, kur ishin në shpellë, kur ai i tha shokut të tij: mos u trishto, Allahu është me ne”.

“N'dashtë Ai që ne të rrojmë,
S'ka fuqi që na merr jetën;

N'dashtë Ai që ne të vdesim;

S'ka shteg që na ndjell frikën.”

Në rrugëtimin e ashpër të jetës,

shtrëngatave ballë t'u bëjmë;

Zotin ta kemi shkëmbin e shpresës

Te Ai lundrën ta lidhim

Në ardhhtë begatia: Atij i takon lavdia

Në ardhhtë mjerimi: shpresën tek Ai e kemi.

Edhe vdekja është lumni për zemrat me siguri

Çfarë të ketë shkruajtur Ai, është më e mira dobi.

Për Tyssen, dhe paraardhësit e bashkësisë tonë myslimane britanike, Islami është katërcipërisht feja e nënshtrimit: jo vetëm e *emr teklifi*-t të Zotit: urdhëresat e Sheriatit; por edhe e *emr tekuini*-t të Tij: urdhëri i Tij që i jep trajtë çdo ngjarjeje në botë, përfshirë urdhërin që thotë se ne duhet të vdesim. Kjo e jona është feja e *teuekkulit*, *rizasë*, dhe *teslimit*, dhe kjo në formën më krenare dhe më të jashtëzakonshme.

Në këtë mënyrë, *veliu*, personi vërtet mysliman, është prej atyre të cilët “*la khaufun 'alejhim ue-la hum juhzenun*”: ata nuk i kaplon frika, dhe as nuk i kap trishtimi. Sepse Zoti na ka urdhëruar që të themi: “*len jusibene il-la ma ketebe'Llahu lena*”: asgjë nuk do të na bjerë mbi krye përpos asaj çfarë ka shkruajtur Zoti për ne.

Kështu, ne pikëllohem për të vdekurit tanë, dhe ky është një refleks i natyrshëm dhe shëronjës; dhe ne i besojmë mjekësisë; por ne nuk biem pre e panikut. Vdekja është një pjesë e natyrshme e sistemit të lavdishëm të universit të Zotit, me ciklet e tij të lindjes, rritjes, pjellorisë lulëzuese, dhe vdekjes – një krijim që përmban *xhelal* dhe *xhemal*, Rreptësi dhe Bukuri. Siç shkruan poeti turk Ibrahim Hakiu:

Ç'vjen prej Teje, melhem për mua;

Gonxhe trëndafili qoftë, a gjemb i tij,

Një rrobë nderi, a qefin' i vdekjes,

E mirë është butësia Jote; e mirë është rreptësia Jote.

Prandaj, vajtimi modern i botës të cilin ne e dëgjojmë përreth nesh, përfshirë dhe atë të Amalekitëve të epokës, si Donald Trump, i cili duket qartë që është i tmerruar dhe ka hallin se mos një mushkonjë i hyn në hundë, nuk është një kor të cilit ne mund t'i bashkohemi: më saktë, ne instiktivisht themi: "*Hasbuna Allahu ue ni'me l-ueki!*", Allahu na mjafton, dhe Ai është një Mbrojtës i shkëlqyer: ose nethemi, "*Inne li'lahi ue inne ilejhi raxhi'un*": të Zotit jemi, dhe tek Ai do të kthehemi.

Vite më parë më ka rënë për hise që të udhëtojë me taksi me shumë njerëz që bënë ecejake me një shpejtësi alarmuese sa nga Xheddah në Medine. Zakonisht bëhej fjalë për automjete karakatinë të mbushura dingas me punonjës jemenas; dhe në një numër rastesh, i kemi shpëtuar Ëngjellit të Vdekjes për fije. Një natë, kur njëri prej atyre shoferëve po ecte me 150 kilometra në orë, një tufë me deve kapërceu autostradën mu përpara nesh; me ndoshta dhjetë përqind mundësi mbijetese, shoferi reagoi menjëherë, duke e manovruar mjetin në një hapësirë të ngushtë midis kafshëve që po shtynin njëra tjetrën; dhe ne mbijetuam. *Ja Allah*, O Zot, thanë të gjithë pasagjerët, teksa Vdekja krejt papritmas u turr drejt nesh, dhe më pas, *Subhan Allah*, o Zot të qofshim falë. Pak çaste më vonë, ngjarja e humbi peshën që kishte patur në atë moment të parë.

Pak më tutje, kur u ndalëm në një karburant në autostradën saudite, më zunë sytë një plak të vjetër që ishte ulur në beton dhe që po shiste kaligrafi kuranore në korniza. Shiste vetëm një tekst: "*kul-lu nefsini dha'ikat el-meut*", cdo shpirt ka për ta shijuar vdekjen. Sigurisht, puna nuk do t'i ecte aspak mirë në një Parking Pushimi në një autostradë britanike dosido. Por për myslimanët, vdekja është thjesht një tjetër aspekt i përvojës njerëzore, një dekret nga urtësia e Tij, modaliteti dhe koha e së cilës përcaktohen nga Më i Miri i gjykatësve.

Megjithatë, *khaufi* dhe *huzni* aktual, apo frika dhe trishtimi aktual, që po paralizojnë botën tonë që supozohet se i ka parë të gjitha dhe se është e sofistikuar, nuk kanë të bëjnë vetëm me vdekjen, por edhe me brishtësinë e *dynjasë* gjithashtu. Indeksi i aksioneve FTSE ka prekur fundin: tridhjetë e pesë përqind në zonën e kuqe, dhe është ende në rënie; papunësia po rritet dhjetë herë më shpejt se sa mbas krizës financiare të vitit 2008; bizneset po ulin qepenat dhe po mbyllen për fare. Të varfërit dhe të pashpresët, me kontrata afat-shkurtra apo me kontrata të tipit "paguhesh po pati punë", po përballen që tani me urinë. Kjo do të ketë një impakt të rëndë mbi bashkësinë tonë: restorantet tanduri dhe bizneset e taksive (shumë të punësuar në këto zanate janë nga bashkësia e myslimanëve në Britani sh.p.) janë mjaft të cënueshëm; atyre që iu është mohuar azili dhe atyre pa vizë mund t'iu mohohet edhe shërbimi shëndetësor. Siç ndodh rëndom, më të dobtit dhe më të varfërit vuajnë më tepër nga të gjithë; por ky është fati i Ismailit: ne jetojmë në anën e gabuar të murit të Gazas. Sërish, ne pasqyrojmë se në një epokë të pabarazive dhe arrogancës titanike përherë e në rritje, Zoti është gjithnjë me të dobtit që vuajnë, me të uriturit dhe më të përçmuarit; vetë Pejgamberi ka bërë dua që të ringjallet në mesin e të varfërve.

Në dynja ne kemi nevojë për gjërat bazë, ne kemi të drejtë që të kërkojmë *kutin* tonë, bukën tonë të përditshme. Por dashuria e çmendur për konsum, e cila është shndërruar në vartësinë vdekjeprurëse të njeriut modern, është e urryer për Qiellin. Kurani thotë: "*Dijeni se jeta e kësaj dynjaje është vetëm një lojë, dhe stolisje, dhe mburrje në mesin tuaj. Dhe jeta e kësaj bote është vetëm shijimi i iluzionit.*"

Vartësia jonë nga produktet po sakaton Nënë Tokë; nga këndeja vjen dhe ideja jonë se vetë njerëzimi është një sëmundje që po vret bujtësen e tij planetare: ne jemi të gjithë virusi Karun. Por ky virus po vret edhe shpirtrat tanë dhe shoqëritë tona pa dallim. Besimtari/ja nuk është fort i/e dhënë pas *shopping* dhe pazarit, ndonëse ajo apo ai gjen kënaqësi kur e gostis mikeshën apo mikun; shtëpia e

Pejgamberit ishte kaq e thjeshtë saqë dhe portën e shtëpisë nuk e kishte prej druri, por prej një cope të thjeshtë lecke. *Kun fi d-dunja ke-enneke gharibun eu ebire sebil*, ka thënë ai: “Në këtë botë sillu sikur të jesh i huaj apo udhëtar.”

Kështu që besimtari, në veçim, i largohet më tutje dunjasë, shkëputet prej saj, dhe ripërtërin një pjesë të dobive kyce të *khalue-s* apo *'uzle-s*, duke sjellë në kujtesë mundësinë e përjetimit të pastërtisë së zemrës atje ku hutimet dhe kënaqësitë e kësaj dynjaje i ke aty ngjitur: Virgjëresha e Bekuar (Merjeme/Mari) pa ëngjëllin kur ajo ishte krejt e vetme në shkretëtirë, dhe i njëjti ëngjëll i erdhi më të Mirit të Krijimit [Pejgamberit] kur ai ishte i vetëm, *jetehenneth*, në Shpellën Hira.

Çasti ynë, pra, është një mundësi për të riaktivizuar zakonet e nderuara të *khalvetit* dhe *itikafit*, të cilat kanë shpërblime të mëdha. Ndoshta, në qoftëse parashikimet e qeverisë për një hapje në krye të trekatër javëve të ardhshme bëhen realitet, atëherë ky ka për të qenë një veçim dyzet ditor. Literalisht, një karantinë e vërtetë, një *erbain*, një izolim dyzet ditor. Gjatë kësaj kohe, bota materialiste ateiste ka për të vuajtur nga mërzia, frika dhe ankthi financiar. Dilema e saj është e qartë! Ose njerëzit të rrinë të shtëpi, ose ekonomia të ringjallet. Frika nga vdekja dhe frika nga varfëria janë dy gjigandë të trazuar të cilët po përleshën në zemrat e tyre.

Në varësi të masës në të cilën ne e kemi brendësuar Islamin tonë, ne nuk do të vuajmë shumë nga përleshje të tilla apo nga frikëra të tilla. E ardhmja është e Zotit, jo e njeriut; gjithçka është e Tij, dhe ne udhëtojmë në të si ta ketë shkruajtur Ai.

Ndërkohë, ne e përjetojmë këtë karantinim nga bota. Le të shqyrtojmë librin e autores myslimane gjermane Michaela Oezsel të titulluar *Dyzet Ditë*, i cili është ditari i një veçimi dyzet ditor. Ajo ka mbajtur shënim se si çdo ditë e re e shton ndërgjegjësimin për veten, dhe mirënjohjen e habinë për afërsinë e Zotit të Plotfuqishëm, si dhe një sens jete dhe një sens krijimi si një dhuratë e kulluar, e pamerituar dhe e mahnitshme. Më ka ngelur e ngulitur në zemër se si udhërrëfyeni i saj shpirtëror këndon dua/lutje teksa ajo hyn në apartamentin ku do të kryejë këtë veçim shpirtëror dyzet ditor, përpara se të mbyllë derën me shprehjen tradicionale: *jumushak geçsin*, të qoftë i butë e i lehtë.

Për shumë njerëz, izolimi është i lodhshëm dhe dëlirësia e përqendrimit shpirtëror duket si një shpresë jorealiste: fëmijët bëjnë zënka me njëri tjetrin dhe kanë nevojë për ushtrime, ne na merr malli për miqtë, dhe, kjo është edhe dhimbja më e madhe, në këtë Ramazan ka të ngjarë që të mos e kemi madhështinë e pakohë të namazit të Teravijeve. Zemrat tona kanë mall për xhamitë, dhe në këtë distancë ne mësojmë se sa shumë kemi nevojë për format e bukura dhe shëruese të praktikave tona, dhe ne kuptojmë, me trishtim, se sa e varfër është jeta e atyre që nuk kanë Zot.

Por Islami nuk ka as priftëri dhe as kishë të konsakruar: i Zgjedhuri [Muhamed Mustafai] na thotë se njëra nga *khasa'is*, karakteristikat e veçanta, të Ymetit të tij është se “e gjithë toka është bërë xhami për mua”. Në pothuajse çdo shtëpi ka një njeri që mund të udhëheqë namazin, madje edhe në nivel bazik; agjërimi mund të vijojë në një mënyrë plotësisht të vlefshme nga pikëpamja e Sheriatit; zekati fitri nuk ka pse mos të paguhet: Islami është krejtësisht i mundur në veçimin tonë.

Pra, le të mësojmë rishtazi traditat e veçimit, *'uzle-së*. Dhe le të mos harxhojmë kohën kot, por ta shfrytëzojmë këtë mundësi. Ne mund të lexojmë libra më tepër se sa ç'kemi bërë më parë:

Ni'me'l-enisu kitabi / in feteke'l-as'habu

“Libri është miku më i mirë / kur miqtë nuk gjenden”

Teksa ne kalojmë ditët tona në një shkëputje të paqtë dhe zemrat tona qetësohen, në një mënyrë të mistershme ne mund të vendosim një lidhje me shpirtrat e dijetarëve të epokave të shkuara, duke lexuar me respekt veprat e tyre; ne, në njëfarë kuptimi të misterhëm, mund të bëhemi nxënësit e tyre, ne mund t'i gëzohemi shoqërisë së tyre.

Në të njëjtën mënyrë ne duhet të kryejmë namazin në shtëpitë tona, duke kujtuar urdhëresën peygamberike se shtëpitë tona nuk duhet të bëhen si varre, por duhet të gjallërohen me anë të namazit. Ezani duhet të recitohet me zë të lartë dhe në kohë. Në rrjet duhet të dëgjojmë recitime kuranore *live* dhe jo thjesht regjistrime. Ne mund ndjekim leksione islame *online* dhe të mësojmë sistematikisht gjëra që duhet t'i kishim mësuar shumë kohë më parë, sidomos obligimet themelore, apo *farzet ajan*. Kjo mund të jetë një mundësi që na jepet një herë në jetë për shtuar dijen, apo ilmin, për të plotësuar ato boshllëqe që duhet t'i kishim mbushur me herët, dhe për të shijuar bereqetin unik të veprave, *'amel*, shtesë.

Në kohëra fitneje, sidomos në mesin e rebelimeve dhe brengave afër fundit të kohërave, udhëzimi peygamberik kërkon që, fillimisht, të thyesh shpatën tënde: *“ue'dribu bi sujufikum el-hixhare”*, dhe të bëhesh një orendi në shtëpinë tënde: *“kun hilsen min ehlesi bejtik.”* Qëllimi duhet të jetë që të shmangen hutimet e botës së trazuar jashtë: në shumë vende, për shembull, joshja e shikimit tradhtar gjatë verës kur njerëzit vishen hollshëm, rreziku i bashkëbisedimeve të pavenda, i përgojimit dhe shpifjes, i ekspeditave të pakuptimave për të bërë *shopping*, dhe drekat e darkat ekstravagante nëpër restorante – por imamët tanë, përfshirë Imam Gazaliun, theksojnë se qëllimi duhet të jetë pikë së pari që të ruajmë të tjerët nga të këqijat tona, jo të ruajmë veten nga të këqijat e të tjerëve. Duke u vetizoluar, ne shmangim infektimin e njerëzve të tjerë me zakonet tona të liga dhe *edebin*, edukatën, tonë të varfër. Sot ne i shkaktojmë më pak dëm botës.

Kështu, ne i lutemi Allahut, ndoshta në natën e mesit të Sha'banit, që kjo mundësi për veçim të jetë për ne një kohë e bereqetshme, e *sabrit* dhe e *shukrit*, e *teuekkulit* dhe *teslimit*, dhe që Ai të ketë shkruar një fund të plot mirësi. Ne të gjithë po rendim shumë shpejt pas botës, dhe ne duhet të ndalemi e të marrim frymë thellë për një copë herë. Dhashtë Zoti që ne të hyjmë në këtë Ramazan në një gjendje të qetë dhe të mirëpërgatitur të namazit dhe me vëmendje të plotë ndaj detyrave tona dhe pranisë së Zotit të Plotfuqishëm. Qoftë ky Ramazani më i mirë i jetës sonë, i çliruar nga dembelizmi dhe plot me dashuri konstruktive në familje, plot me falje, lutje dhe përftim dijeje. Dhashtë Zoti që ky vetizolim të përfundojë, sikundër përfundon gjithmonë Ramazani, jo me një ndjesi çlirimi, por me atë ndjesinë se kemi përjetuar një kohë të përsjirtshme dhe të veçantë, dhe se ka për të na marrë malli për të.

Dhe ne do të lutemi gjithashtu që stafi mjekësor të ketë fuqi, që rahmeti të kaplojë të vdekurit tanë, dhe që *takvaja* në zemrat tona të jetë më e madhe. Dhe ne do të lutemi që të fuqishmit të bëhen të përunjur, që dora e vdekur e materializmit do të largohet nga Beni Ademi, i biri i Ademit, frenetik, lakmitar dhe i stresuar, dhe që kjo të jetë një kohë e *teubes* dhe e reflektimit dhe e rikthimit në *Hak* jo vetëm për Ymetin, Bashkësinë e Besimtarëve, por për të gjithë njerëzimin, i cili ka vuajtur nga gjynahet e veta për një kohë tepër të gjatë, dhe që dëshiron me forcë ndreqjen e mëshirshme e udhëzuese të zemrës së tij, nëpërmjet mëshirës e nurit të Qiellit.

Përktheu: Arjol Guni

Date Created

13/04/2020

Author

timothy-winter